LIGJ
Nr. 92/2026

PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT NDËRKOMBËTAR TË KËRKESAVE PËR UKRAINËN, BËRË NË HAGË MË 16.12.2025

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet Konventa për Themelimin e Komisionit Ndërkombëtar të Kërkesave për Ukrainën, bërë në Hagë më 16.12.2025, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 18.9.2026

Shpallur me dekretin nr. 511, datë 6.10.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj

KONVENTA PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT NDËRKOMBËTAR TË KËRKESAVE PËR UKRAINËN

Hagë, më 16.XII.2025

PREAMBULA

Nënshkruesit e kësaj Konvente,

Duke ditur detyrimet e të gjitha shteteve sipas nenit 2 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, përfshirë detyrimin për tu përmbajtur në marrëdhëniet e tyre ndërkombëtare nga kërcënimi apo përdorimi i forcës ndaj integritetit territorial apo pavarësisë politike të ndonjë shteti, apo të çfarëdo lloj mënyre tjetër që bie ndesh me qëllimet e Kombeve të Bashkuara, si dhe për të zgjidhur mosmarrëveshjet e tyre ndërkombëtare me mjete paqësore;

Duke shprehur shqetësim të thellë për humbjen e jetëve njerëzore, zhvendosjen e civilëve, shkatërrimin e madh të infrastrukturës dhe burimeve natyrore, humbjen e pronës publike dhe private, si dhe pasojat ekonomike të shkaktuara nga agresioni i Federatës Ruse ndaj Ukrainës;

Duke pasur parasysh rëndësinë e ruajtjes dhe forcimit të paqes ndërkombëtare, të bazuar në liri, barazi, drejtësi dhe respekt për të drejtat e njeriut, si dhe zhvillimin e marrëdhënieve miqësore midis kombeve, pavarësisht sistemeve të tyre politike, ekonomike dhe shoqërore apo niveleve të zhvillimit;

Referuar Rezolutës ES-11/1 të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, të datës 2 mars 2022, me titull "Agresioni kundër Ukrainës", në të cilën Asambleja e Përgjithshme e ka dënuar në termat më të ashpër agresionin e Federatës Ruse kundër Ukrainës, në shkelje të nenit 2(4) të Kartës së Kombeve të Bashkuara;

Referuar neneve të Komisionit të së Drejtës Ndërkombëtare mbi Përgjegjësinë e Shteteve për Akte të Kundërligjshme Ndërkombëtare dhe detyrimin e shtetit përgjegjës për të bërë riparimin e plotë të dëmit të shkaktuar nga akti i kundërligjshëm ndërkombëtar;

Referuar Rezolutës 60/147 të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, të datës 16 dhjetor 2005, në të cilën Asambleja e Përgjithshme ka miratuar Parimet dhe Udhëzimet Themelore mbi të Drejtën për Mjete Juridike dhe Dëmshpërblim për Viktimat e Shkeljeve të Rënda të së Drejtës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut dhe të Shkeljeve të Rënda të së Drejtës Ndërkombëtare Humanitare;

Referuar Rezolutës ES-11/5 të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, të datës 14 nëntor 2022, me titull "Promovimi i mjeteve juridike dhe dëmshpërblimit për agresionin kundër Ukrainës", në të cilën Asambleja e Përgjithshme ka theksuar se Federata Ruse duhet të mbahet përgjegjëse për çdo shkelje të së drejtës ndërkombëtare në ose kundër Ukrainës, përfshirë agresionin e saj në kundërshtim me Kartën e Kombeve të Bashkuara, si dhe çdo shkelje të së drejtës ndërkombëtare humanitare dhe së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut;

Duke pasur parasysh se në të njëjtën rezolutë ES-11/5, Asambleja e Përgjithshme ka theksuar më tej se Federata Ruse duhet të mbajë pasojat juridike për të gjitha aktet e saj të kundërligjshme ndërkombëtarisht, përfshirë detyrimin për të dëmshpërblyer për dëmet, humbjet apo lëndimet, të shkaktuar nga këto akte;

Duke pasur parasysh se Asambleja e Përgjithshme ka theksuar më tej nevojën për krijimin, në bashkëpunim me Ukrainën, të një mekanizmi ndërkombëtar për dëmshpërblim të dëmeve, humbjeve apo lëndimeve që rrjedhin nga aktet e kundërligjshme ndërkombëtare të Federatës Ruse në ose kundër Ukrainës;

Duke pasur parasysh se Asambleja e Përgjithshme ka rekomanduar krijimin nga Shtetet Anëtare, në bashkëpunim me Ukrainën, të një regjistri ndërkombëtar të dëmeve, i cili do të shërbejë si një dokumentacion zyrtar i provave dhe informacionit mbi kërkesat për dëmet, humbjet ose lëndimet e pësuara nga të gjitha personat fizikë dhe juridikë përkatës, si dhe nga shteti i Ukrainës, të shkaktuara nga aktet e kundërligjshme ndërkombëtare të Federatës Ruse në ose kundër Ukrainës, si dhe për të promovuar dhe koordinuar mbledhjen e provave;

Duke mirëpritur krijimin e Regjistrit të Dëmeve të Shkaktuara nga Agresioni i Federatës Ruse kundër Ukrainës, nëpërmjet Rezolutës CM/Res(2023)3 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës të datës 12 maj 2023, që krijoi Marrëveshjen e Pjesshme për Zgjerimin sipas Regjistrit të Dëmeve të Shkaktuara nga Agresioni i Federatës Ruse kundër Ukrainës, siç edhe u konfirmua nga Rezoluta CM/Res(2025)3 e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës të datës 9 korrik 2025;

Duke theksuar gjithashtu se Regjistri i Dëmeve të Shkaktuara nga Agresioni i Federatës Ruse kundër Ukrainës është funksional dhe pranon, trajton dhe regjistron kërkesat në përputhje me Statutin e tij;

Referuar Statutit të Regjistrit të Dëmeve të Shkaktuara nga Agresioni i Federatës Ruse kundër Ukrainës, i cili përcakton se funksioni i Regjistrit, përfshirë platformën e tij digjitale me të dhënat mbi kërkesat dhe provat e regjistruara, synon të përbëjë komponentin e parë të një mekanizmi të ardhshëm ndërkombëtar të kompensimit, që do të krijohet me një instrument të veçantë ndërkombëtar në bashkëpunim me Ukrainën;

Duke vënë në dukje se kjo Konventë përbën një instrument të tillë ndërkombëtar dhe se ajo do të krijojë Komisionin Ndërkombëtar të Kërkesave për Ukrainën, i cili përbën komponentin e dytë të mekanizmit ndërkombëtar të kompensimit, që mund të përfshijë gjithashtu, si komponent të tretë, një fond të ardhshëm kompensimi të mandatuar për të paguar kompensimin për dëmet, humbjet ose lëndimet e shkaktuara nga aktet e kundërligjshme ndërkombëtare të Federatës Ruse në ose kundër Ukrainës;

Duke vënë në dukje se, edhe pse kjo Konventë trajton aktet e kundërligjshme ndërkombëtare të kryera nga Federata Ruse në ose kundër Ukrainës pas datës 24 shkurt 2022, kjo nuk përjashton përgjegjësinë e Federatës Ruse për aktet e saj të kundërligjshme ndërkombëtare të kryera në ose kundër Ukrainës pas datës 20 shkurt 2014, dhe as nuk përjashton mundësinë e një ndryshimi të ardhshëm të kësaj Konvente për të zgjatur periudhën e saj kohore deri në 20 shkurt 2014;

Të angazhuar në zbatimin e dispozitave të kësaj Konvente në përputhje me të drejtën ndërkombëtare;

Kanë rënë dakord për këtë Konventë të Hapur të Këshillit të Europës si më poshtë:

KAPITULI I

PËRDORIMI I TERMAVE

Neni 1
Përkufizimet

Për qëllimet e kësaj Konvente:

(a) "Asamble" nënkupton Asamblenë e Anëtarëve të Komisionit, e themeluar në përputhje me nenin 7 të kësaj Konvente;

(b) "Kërkesë", sipas nenit 3 të kësaj Konvente, nënkupton kërkesat e paraqitura në Regjistrin e Dëmeve të Shkaktuara nga Agresioni i Federatës Ruse kundër Ukrainës në përputhje me rregullat e tij dhe, pas transferimit funksional të Regjistrit te Komisioni, sipas Kapitulit VII të kësaj Konvente, kërkesat e paraqitura në përputhje me rregullat dhe procedurat e përmendura në nenin 25 të kësaj Konvente;

(c) "Komision" nënkupton Komisionin Ndërkombëtar të Kërkesave për Ukrainën, i ngritur nga kjo Konventë;

(d) "Komisioner" nënkupton një individ të zgjedhur si anëtar të një Paneli në përputhje me nenin 11 të kësaj Konvente;

(e) "Këshill" nënkupton Këshillin e Komisionit, të krijuar në përputhje me nenin 10 të kësaj Konvente;

(f) "Drejtor Ekzekutiv" nënkupton Drejtorin Ekzekutiv të Komisionit, të emëruar në përputhje me nenin 14 të kësaj Konvente;

(g) "Komiteti Financiar" nënkupton Komitetin Financiar të Komisionit, të ngritur në përputhje me nenin 8 të kësaj Konvente;

(h) "Kontribues Kryesor" nënkupton çdo Anëtar i cili, gjatë një viti financiar, kontribuon me nivelin më të lartë të kontributeve të detyrueshme në buxhetin e Komisionit, bazuar në kriteret e përcaktuara në Rezolutën (94)31 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës, të datës 4 nëntor 1994;

(i) "Anëtar" nënkupton çdo shtet ose Organizatë Rajonale Integrimi që është bërë Anëtar i Komisionit duke u bërë Palë në këtë Konventë në përputhje me nenet 28, 30 ose 31 të kësaj Konvente;

(j) "Vëzhgues" nënkupton çdo shtet, Organizatë Rajonale Integrimi ose organizatë ndërkombëtare që është bërë Vëzhgues i Komisionit në përputhje me pikën 2 të nenit 27 të kësaj Konvente;

(k) "Panel" nënkupton një Panel Komisionerësh të të ngritur sipas nenit 12 të kësaj Konvente;

(l) "Organizatë Rajonale Integrimi" nënkupton një organizatë të krijuar nga shtete sovrane të një rajoni të caktuar, të cilave shtetet anëtare u kanë transferuar kompetenca për çështjet e rregulluara nga kjo Konventë;

(m) "Regjistri i Dëmeve të Shkaktuara nga Agresioni i Federatës Ruse kundër Ukrainës" ose "Regjistri" nënkupton Regjistrin e krijuar nëpërmjet Rezolutës CM/Res(2023)3 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës, të datës 12 maj 2023, dhe të konfirmuar nga Rezoluta CM/Res(2025)3 e Komitetit të Ministrave të datës 9 korrik 2025;

(n) "Rregulla dhe Rregullore" nënkupton rregullat dhe rregulloret që rregullojnë punën e Komisionit, të miratuara nga Këshilli në përputhje me paragrafin 2(c) të nenit 10 të kësaj Konvente dhe të miratuara nga Asambleja në përputhje me paragrafin 4(c) të nenit 7 të kësaj Konvente;

(o) "Sekretariat" nënkupton Sekretariatin e Komisionit të krijuar në përputhje me nenin 13 të kësaj Konvente.

KAPITULLI II
THEMELIMI, MANDATI DHE FUNKSIONET E KOMISIONIT NDËRKOMBËTAR TË KËRKESAVE PËR UKRAINËN

Neni 2
Themelimi i Komisionit Ndërkombëtar të Kërkesave për Ukrainën

Komisioni Ndërkombëtar i Kërkesave për Ukrainën krijohet me këtë Konventë si një organ i pavarur brenda kuadrit institucional të Këshillit të Europës.

Neni 3
Mandati dhe Funksionet e Komisionit

1. Komisioni do të jetë një organ administrativ që shqyrton kërkesat për kompensim për dëmet, humbjet ose lëndimet e shkaktuara nga aktet e kundërligjshme ndërkombëtare të kryera nga Federata Ruse në ose kundër Ukrainës, përfshirë agresionin e saj në shkelje të Kartës së Kombeve të Bashkuara, si dhe çdo shkelje nga Federata Ruse të së drejtës ndërkombëtare humanitare dhe të së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut:

(a) më ose pas datës 24 shkurt 2022;

(b) (i) në territorin e Ukrainës brenda kufijve të saj të njohur ndërkombëtarisht, përfshirë tokën, hapësirën ajrore, ujërat e brendshme dhe detin territorial;

(ii) në zonën ekonomike ekskluzive të Ukrainës dhe në shelfin kontinental të saj, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare dhe, sipas rastit, me legjislacionin kombëtar të Ukrainës; ose

(iii) ndaj çdo aeroplani ose anijeje nën juridiksionin e Ukrainës;

(c) në lidhje me të gjithë personat fizikë dhe juridikë përkatës, si dhe ndaj shtetit të Ukrainës, përfshirë autoritetet e saj rajonale dhe lokale, si dhe subjektet shtetërore ose të kontrolluara nga shteti.

2. Për qëllimet e kësaj Konvente, mandati i Komisionit sipas paragrafit 1 më sipër nënkupton se Komisioni do të shqyrtojë, vlerësojë dhe vendosë mbi kërkesat dhe do të përcaktojë shumën e çdo kompensimi të detyrueshëm në secilin rast.

3. Komisioni do të trajtojë të gjitha çështjet administrative, financiare, procedurale, faktike, juridike dhe të politikave, sipas nevojës, për të shqyrtuar kërkesat dhe për të përcaktuar shumën e kompensimit të detyrueshëm në secilin rast.

4. Komisioni do të veprojë nën idenë se Federata Ruse, sipas së drejtës ndërkombëtare, është përgjegjëse për të gjitha dëmet, humbjet ose lëndimet e shkaktuara nga aktet e saj të kundërligjshme ndërkombëtare në ose kundër Ukrainës, në përputhje me paragrafin 1 më sipër.

5. Vendimet e Komisionit, përfshirë ato mbi shumën e kompensimit të përcaktuar dhe të dhënë në përputhje me këtë Konventë, do të jenë përfundimtare. Vendimet mbi kompensimet duhet të pasqyrojnë një vlerësim dhe përcaktim të drejtë dhe të paanshëm të vlerës së kërkesës.

6. Vendimet e Komisionit do të konsiderohen, për sa i përket funksionimit të Komisionit, si zgjidhje përfundimtare nga të gjithë Anëtarët e Komisionit për të gjitha çështjet faktike dhe juridike që lidhen me një kërkesë.

KAPITULLI III
STATUSI JURIDIK DHE SELIA

Neni 4
Personaliteti Juridik

1. Komisioni do të ketë personalitet juridik ndërkombëtar.

2. Në përputhje me këtë, Komisioni do të ketë kapacitetin juridik të nevojshëm për ushtrimin e funksioneve të tij, përmbushjen e mandatit dhe mbrojtjen e interesave të tij, në veçanti kapacitetin për të lidhur marrëveshje, për të fituar dhe shitur pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme, si dhe për të ushtruar veprime ligjore.

Neni 5
Selia

1. Komisioni do të ketë selinë në territorin e njërës prej Palëve të kësaj Konvente.

2. Statusi dhe funksionimi i Komisionit në shtetin pritës do të rregullohet nëpërmjet një marrëveshje ndërmjet shtetit pritës dhe Komisionit.

3. Komisioni do të ketë një zyrë në Ukrainë për të ndihmuar Asamblenë, Këshillin dhe Panelet në ushtrimin e funksioneve të tyre.

4. Komisioni do të hyjë në marrëveshje dhe/ose dakordësime me Ukrainën, të cilat do të rregullojnë statusin dhe funksionimin e zyrës së Komisionit në Ukrainë.

5. Asambleja mund të vendosë të themelojë zyra të Komisionit në çdo shtet tjetër, me kusht miratimin e këtij shteti.

Neni 6
Privilegjet dhe Imunitetet

1. Komisioni, përfshirë zyrën e tij në Ukrainë dhe çdo zyrë tjetër në shtete të tjera, do të gëzojë në territorin e çdo shteti Anëtar privilegjet dhe imunitetet e nevojshme për ushtrimin e funksioneve dhe përmbushjen e mandatit të tij.

2. Shtetet Anëtare do të zbatojnë në territorin e tyre rregullat e përcaktuara në Marrëveshjen e Përgjithshme mbi privilegjet dhe imunitetet e Këshillit të Europës lidhur me Komisionin, zyrat e tij, Drejtorin Ekzekutiv, Anëtarët e tjerë të Sekretariatit dhe ekspertët e angazhuar nga Komisioni, veçanërisht:

(a) Nenet 3 deri në 7 të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi privilegjet dhe imunitetet e Këshillit të Europës, lidhur me Komisionin, përfshirë zyrat, pasuritë dhe asetet e tij;

(b) Nenin 18 të kësaj Marrëveshjeje lidhur me Drejtorin Ekzekutiv dhe Anëtarët e tjerë të Sekretariatit;

(c) Nenit 18(a) dhe (e) të kësaj Marrëveshjeje lidhur me ekspertët e angazhuar nga Komisioni.

3. Shtetet Anëtare do të kenë në territorin e tyre të njëjtat privilegje dhe imunitete të parashikuara në nenin 16 të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Privilegjet dhe Imunitetet e Këshillit të Europës lidhur me Komisionerët gjatë angazhimit në punën e Komisionit.

4. Përfaqësuesit e Anëtarëve në organet e Komisionit, Komisionerët, Drejtori Ekzekutiv, Anëtarët e tjerë të Sekretariatit dhe ekspertët e angazhuar nga Komisioni do të kenë imunitet nga ndjekja ligjore për çdo fjalë të shkruar ose të thënë dhe çdo veprim të kryer në funksionin e tyre zyrtar në territorin e çdo shteti anëtar, dhe do ta ruajnë këtë imunitet edhe pas përfundimit të mandatit të tyre.

5. Çdo shtet anëtar mund, nëpërmjet një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, të deklarojë se imuniteti nga ndjekja ligjore dhënë sipas paragrafëve 2, 3 dhe 4 më sipër nuk do të zbatohet për raste shkeljesh të rregullave të trafikut me automjete ose për dëme të shkaktuara nga automjetet e personave përkatës.

6. Privilegjet dhe imunitetet e:

(a) Komisionerëve mund të hiqen nga Asambleja;

(b) Drejtorit Ekzekutiv, anëtarëve të tjerë të Sekretariatit dhe ekspertëve të angazhuar nga Komisioni mund t'u hiqen nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

7. Imuniteti i parashikuar në paragrafin 2(a) mund të hiqet nga Asambleja. Një heqje e tillë e imunitetit nuk do të shtrihet në asnjë masë ekzekutive ndaj apo konfiskimit të pasurive të Komisionit, përfshirë platformën digjitale dhe të të gjitha të dhënave për kërkesat dhe provat, për të cilat do të jetë e nevojshme një përjashtim i veçantë nga Asambleja.

8. Në rast të denoncimit nga ndonjë Anëtar ose përfundimit të kësaj Konvente, Anëtarët do të vazhdojnë t'i njohin imunitetet e parashikuara në këtë Nenin.

KAPITULLI IV
STRUKTURA ORGANIZATIVE

Neni 7
Asambleja

1. Asambleja përbëhet nga të gjithë Anëtarët e Komisionit.

2. Asambleja mblidhet në selinë e Komisionit, përveç rasteve kur Asambleja vendos ndryshe. Mbledhja e parë e Asamblesë thirret nga depozitari i kësaj Konvente brenda një viti pas hyrjes së saj në fuqi.

3. Asambleja zgjedh një Kryetar dhe dy Zëvendëskryetarë për një periudhë trevjeçare. Kryetari i Asamblesë, ose në mungesë të Kryetarit, një nga Zëvendëskryetarët, udhëheq punimet e Asamblesë dhe kryen detyrat e tjera në përputhje me rregullat e procedurës të miratuara nga Asambleja.

4. Asambleja:

(a) ka përgjegjësi të plotë për përmbushjen e mandatit të Komisionit dhe mbikëqyr punën e organeve të Komisionit;

(b) u rekomandon Anëtarëve, organeve të Komisionit, si dhe organeve mvartëse siç edhe theksohet në nënparagrafin (i) më poshtë, masa për avancimin e qëllimeve të Komisionit;

(c) miraton rregullat dhe rregulloret që do të udhëheqin punën e Komisionit, të miratuara nga Këshilli në përputhje me nënparagrafin 2(c) të nenit 10 të kësaj Konvente;

(d) zgjedh Anëtarët e Këshillit në përputhje me nenit 10 të kësaj Konvente;

(e) miraton listën e kandidatëve për të shërbyer si Komisionerë dhe përditësimet e kësaj liste të paktën një herë në vit;

(f) në mbledhjen e parë, dhe më pas sipas nevojës, zgjedh Drejtorin Ekzekutiv të Komisionit për emërim nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës;

(g) autorizon Drejtorin Ekzekutiv të ekzekutojë transferimin e Regjistrit tek Komisioni në përputhje me nenet 24 dhe 25 të kësaj Konvente, në kohën kur Asambleja e konsideron të përshtatshme, duke marrë parasysh pasojat për kontributet vjetore të Anëtarëve;

(h) me rekomandimin e Këshillit, autorizon Këshillin të krijojë Panelet dhe të emërojë Komisionerët e nevojshëm në kohën që Asambleja e konsideron të përshtatshme, duke marrë parasysh pasojat për kontributet vjetore të Anëtarëve;

(i) me rekomandimin e Këshillit dhe/ose Drejtorit Ekzekutiv, krijon çdo organ mvartës të nevojshëm për ushtrimin e funksioneve të Komisionit;

(j) miraton shkallën vjetore të kontributeve;

(k) miraton buxhetin vjetor të Komisionit;

(l) miraton raportin financiar vjetor të Komisionit;

(m) miraton raportin vjetor të aktivitetit të Komisionit; dhe

(n) kryen çdo funksion tjetër që i ngarkohet në këtë Konventë dhe çdo funksion tjetër të nevojshëm për përmbushjen e mandatit të Komisionit që nuk i është ngarkuar Këshillit me këtë Konventë, Paneleve të Komisionerëve, Drejtorit Ekzekutiv ose Sekretariatit. Asambleja mund t'ia delegojë disa ose të gjitha këto funksione Këshillit.

5. Asambleja mblidhet sa herë të jetë e nevojshme, por të paktën një herë në vit. Asambleja thirret kur ta vendos vetë, kur kërkohet nga Këshilli, ose kur kërkohet nga çdo Anëtar nëse kjo kërkesë mbështetet nga një e treta e Anëtarëve. Kryetari ka të drejtë të thërrasë mbledhje të jashtëzakonshme të Asamblesë në rast nevoje urgjente. Me përjashtim të paragrafit 6 më poshtë, për marrjen e vendimeve në Asamble kërkohet prania e shumicës së Anëtarëve.

6. Asambleja mund ta kryejë marrjen e vendimeve nëpërmjet procedurave me shkrim dhe me mjete elektronike, siç përcaktohet në rregullat e procedurës së Asamblesë.

7. Asambleja mund të krijojë komitete këshillimore për të ndihmuar në punën e saj në fusha specifike që kanë rëndësi për Asamblenë ose Komisionin në përgjithësi.

8. Asambleja miraton rregullat e veta të procedurës dhe çdo rregull ose marrëveshje tjetër të nevojshme për zbatimin e funksioneve të saj.

9. Sekretariati shërben si sekretariat i Asamblesë.

Neni 8

Komiteti Financiar

1. Asambleja krijon Komitetin Financiar si një organ të mvarur të Asamblesë. Komiteti Financiar:

(a) përcakton kontributet vjetore të vlerësuara të Anëtarëve në përputhje me nenin 23(3) të kësaj Konvente;

(b) i ofron këshilla Sekretariatit në përgatitjen e buxhetit të Komisionit;

(c) rishikon projektbuxhetin e Komisionit për vitin pasues, të përgatitur nga Sekretariati, dhe i raporton Asamblesë;

(d) rishikon dhe autorizon mbledhjen e kontributeve nga subjekte të tjera përveç Anëtarëve dhe Vëzhguesve në përputhje me nenin 23(4) të kësaj Konvente;

(e) ofron rekomandime për Asamblenë në lidhje me çështje të tjera financiare të rëndësishme; dhe

(f) kryen çdo detyrë tjetër lidhur me çështje financiare që i caktohet nga Asambleja.

2. Komiteti Financiar përbëhet nga përfaqësues të:

(a) të gjithë Anëtarëve që janë Kontribuesit Kryesorë të buxhetit të Komisionit;

(b) Anëtarëve të tjerë dhe Vëzhguesve që kontribuojnë në buxhetin e Komisionit me një shumë të paktën të barabartë me kontributet e detyrueshme të kontribuesve kryesorë gjatë vitit financiar për të cilin është bërë ky kontribut;

(c) Anëtarëve të tjerë të zgjedhur nga Asambleja.

3. Asambleja e përcakton numrin e Anëtarëve sipas nënparagrafit 2(b) më sipër dhe numrin e Vëzhguesve sipas nënparagrafit 2(c) më sipër. Asambleja i rishikon këto numra çdo vit. Numri i Vëzhguesve nuk duhet të jetë më i madh se numri i Anëtarëve.

4. Në rast se Komisioni merr fonde të mjaftueshme tërësisht nga burime të tjera përveç kontributeve të vlerësuara për të përmbushur nevojat e tij buxhetore, Komiteti Financiar përbëhet vetëm nga përfaqësues Anëtarësh të zgjedhur nga Asambleja.

5. Komiteti Financiar merr përsipër të miratojë vendime me konsensus. Përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe në këtë Konventë, kur përpjekjet për të arritur konsensusin janë shteruar, Komiteti Financiar i merr vendimet me shumicën e dy të tretave të votave të hedhura, ku secili anëtar i Komitetit Financiar ka një votë. Për marrjen e çdo vendimi nga Komiteti Financiar kërkohet prania e shumicës së Anëtarëve.

6. Vendimet për çështje procedurale miratohen me shumicë të votave të hedhura. Nëse ka dyshim ose paqartësi nëse çështja është procedurale, vendimi merret në përputhje me paragrafin 5 më sipër.

7. Komiteti Financiar mblidhet sipas nevojës dhe i raporton Asamblesë. Komiteti Financiar mund të ftojë Anëtarë, Vëzhgues, si dhe Shtete dhe subjekte të tjera që e kanë mbështetur Komisionin financiarisht gjatë periudhës përkatëse të raportimit për të qenë të pranishëm gjatë mbledhjeve të Komitetit Financiar.

8. Sekretariati siguron mbështetjen administrative të nevojshme për Komitetin Financiar.

Neni 9
Votimi në Asamble

1. Nëse një pikë tjetër specifike kërkohet nga ky Konventë, Asambleja merr vendim me shumicë prej dy të tretave të votave të hedhura.

2. Vendimet sipas nënparagrafëve 4 (g) dhe 4(h) të nenit 7 të kësaj Konvente miratohen me shumicë prej dy të tretave të votave të hedhura, përfshirë votat pozitive të të gjithë kontribuesve kryesorë.

3. Vendimet për çështje procedurale miratohen me shumicë të votave të hedhura. Nëse ka dyshim ose paqartësi nëse çështja është procedurale, vendimi merret sipas paragrafit 1 më sipër.

4. Secili Anëtar ka një votë në Asamble.

Neni 10
Këshilli

1. Përbërja e Këshillit do të përcaktohet si vijon:

(a) Këshilli do të përbëhet nga të paktën nëntë dhe jo më shumë se pesëmbëdhjetë Anëtarë. Nëse Asambleja vendos ndryshe, Anëtarët e Këshillit shërbejnë për një periudhë trevjeçare me rrotacion.

Asambleja do të përcaktojë përbërjen e Këshillit nga një listë Anëtarësh që kanë shprehur interes për të shërbyer në Këshill, sipas rendit nëpërmjet të cilit ata janë bënë Anëtarë.

(b) Asambleja do të përcaktojë nëntë Anëtarët e parë që do të përbëjnë Këshillin në mbledhjen e saj të parë ose sa më shpejt që të jetë e mundur pas kësaj.

(c) Asambleja do të përcaktojë tre Anëtarët shtesë të Këshillit në mbledhjen pas depozitimit të instrumentit të tridhjetë të ratifikimit, pranimit, ose miratimit të kësaj Konvente ose Anëtarësimit në këtë Konventë, dhe tre Anëtarë shtesë pas depozitimit të instrumentit të dyzetë.

(d) Kur Ukraina dhe/ose Federata Ruse të jenë anëtare të Këshillit sipas rregullave të nënparagrafit (a) më sipër, ato do të abstenohen nga votimi për nënparagrafët 2(b), 2(c)(ii) deri në (v), dhe 2(d) më poshtë. Kur Ukraina dhe/ose Federata Ruse të jenë Anëtare, por jo anëtare të Këshillit, ato do të ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit me të drejtë për të paraqitur qëndrimet e tyre, por pa të drejtë vote.

(e) Asambleja do të miratojë rregulla që do të rregullojnë rotacionin e Anëtarësisë në Këshill në përputhje me dispozitat e këtij neni, duke siguruar edhe vazhdimësinë kur Anëtarësia të jetë në rrotacion.

2. Këshilli, pa cënuar nenin 7 të kësaj Konvente:

(a) ka përgjegjësi për ushtrimin e mandatit të Komisionit;

(b) emëron Komisionerët nga lista e kandidatëve të miratuar nga Asambleja në përputhje me nënparagrafin 4(e) të nenit 7 të kësaj Konvente dhe krijon Panelet sipas nenit 12 të kësaj Konvente;

(c) miraton rregullat dhe rregulloret që rregullojnë punën e Komisionit, të cilat më pas miratohen nga Asambleja, duke përfshirë përcaktimin e:

i. rregullave dhe procedurave për emërimin dhe shkarkimin e Komisionerëve në Panele;

ii. rregullave dhe procedurave për dorëzimin, shqyrtimin, vlerësimin dhe vendimmarrjen për kërkesat, si dhe për përcaktimin e shumës së kompensimit të detyrueshëm në çdo rast;

iii. standardeve dhe kërkesave për provat;

iv. rregullave për vlerësimin e dëmit, humbjes, ose lëndimit;

v. standardeve dhe metodave për kompensimin;

vi. procedurave për zgjidhjen e çështjeve të kontestuara;

vii. rendit të përparësisë për shqyrtimin, vlerësimin dhe vendimmarrjen për kërkesat;

viii. rregullave dhe procedurave të nevojshme për vazhdimin e e funksionit të Regjistrit brenda kuadrit të Komisionit; dhe

ix. çështjeve të tjera që janë në kompetencë të Këshillit;

(d) ka autoritetin që të miratojë ose rrëzojë rekomandimet e Paneleve për vendimet lidhur me shumën e kompensimit të detyrueshëm për kërkesat e shqyrtuara nga Panelet, si dhe në lidhje me bazën ligjore dhe faktike të rekomandimeve, në përputhje me nenet 17 dhe 18 të kësaj Konvente; dhe

(e) kryen çdo funksion tjetër që i delegohet nga Asambleja.

3. Këshilli do të mblidhet rregullisht për të shqyrtuar rekomandimet e Paneleve për vendimet lidhur me kërkesat e shqyrtuara dhe për të marrë çdo vendim tjetër të nevojshëm për kryerjen e funksioneve të tij. Sekretariati mund të marrë pjesë në mbledhjet e Këshillit në rol këshillues.

4. Këshilli do të përpiqet të marrë vendimet me konsensus. Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë Konventë, kur përpjekjet për arritjen e konsensusit kanë shteruar, Këshilli merr vendimet me shumicë prej dy të tretave të votave të hedhura, ku secili anëtar ka një votë. Sipas paragrafit 5 më poshtë, prania e shumicës së Anëtarëve të Këshillit kërkohet për çdo vendimmarrje të Këshillit.

5. Këshilli mund ta ushtrojë vendimmarrjen nëpërmjet procedurës me shkrim dhe me mjete elektronike siç edhe përcaktohet në rregullat e procedurës.

6. Vendimet për çështje procedurale miratohen me shumicë të votave të hedhura. Nëse ka dyshim ose paqartësi nëse çështja është procedurale, vendimi merret sipas paragrafit 4 më sipër.

7. Këshilli miraton rregullat e saj të procedurës dhe çdo rregull tjetër të nevojshëm për zbatimin e funksioneve të tij. Këshilli zgjedh një Kryetar dhe një ose dy Zëvendëskryetarë nga Anëtarët e tij për një mandat njëvjeçar me mundësi rizgjedhjeje.

8. Këshilli i paraqet raporte Asamblesë dy herë në vit. Këto raporte duhet të përfshijnë numrin e kërkesave të shqyrtuara nga Këshilli dhe shumën totale të kompensimit të caktuar në secilën kategori, si

dhe një përmbledhje të çështjeve të tjera të rëndësishme faktike ose ligjore që lidhen me punën e Komisionit.

Neni 11
Komisionerët

1. Emërimi i komisionerëve do të bëhet në mënyrë gjithëpërfshirëse, duke pasur parasysh nevojën për pavarësi, paanshmëri, integritet, karakter të lartë moral, përvojë, ekspertizë profesionale shumëdisiplonore, përfaqësim të gjerë gjeografik dhe balancë gjinore. Komisionerët duhet të jenë ekspertë në fusha të tilla si e drejta ndërkombëtare, zgjidhja e mosmarrëveshjeve, financat, kontabiliteti, sigurimet, ose vlerësimi i dëmeve. Këshilli mund të vendosë kërkesa shtesë për emërimin e komisionerëve për të administruar nevojat specifike të Paneleve.

2. Kandidatët për komisionerë mund të nominohen nga Anëtarët. Kandidatët gjithashtu mund të aplikojnë drejtpërdrejt për të shërbyer si komisionerë. Sekretariati do të organizojë procesin e nominimit dhe aplikimit, do të bëjë përzgjedhjen e kandidatëve dhe do të krijojë listën e kandidatëve të kualifikuar për të shërbyer si komisionerë.

3. Sekretariati do t'i dorëzojë listën e kandidatëve për miratim Asamblesë. Sekretariati do t'i dorëzojë një listë të përditësuar Asamblesë për miratimin e saj ççdo vit, ose sipas kërkesës së Asamblesë ose Këshillit.

4. Kandidatët nuk mund të përjashtohen vetëm duke u bazuar në shtetësinë e tyre.

5. Kushtet e angazhimit të omisionerëve, përfshirë pagesën e tyre, do të përcaktohen nga Këshilli.

6. Komisionerët do të veprojnë sipas kapaciteteve individuale dhe duhet të jenë të disponueshëm për të kryer detyrat e tyre në mënyrë efektive.

Neni 12
Panelet

1. Panelet do të ngrihen nga Këshilli për të shqyrtuar dhe vlerësuar kërkesat dhe për të përcaktuar çdo shumë kompensimi që i takon secilit rast. Ata do të bëjnë rekomandime rreth vendimeve për Këshillin për tu miratuar.

2. Këshilli, me rekomandimin e Sekretariatit dhe duke pasur parasysh efikasitetin, fleksibilitetin dhe ngarkesën e punës, do të përcaktojë numrin e Paneleve që do të themelohen si dhe mandatin e secilit Panel.

3. Çdo Panel do të përbëhet nga tre Komisionerë të emëruar për atë Panel nga Këshilli.

4. Komisionerët e secilit Panel, me konsensus, do të caktojnë nga radhët e tyre Kryetarin e atij Paneli. Nëse nuk arrijnë konsensus, kryetari do të caktohet nga Këshilli.

Neni 13
Sekretariati

1. Komisioni do të ketë një Sekretariat i cili do të drejtohet nga një Drejtor Ekzekutiv.

2. Sekretariati, nën autoritetin e Drejtorit Ekzekutiv, do të sigurojë mbështetje në përmbajtje, teknike dhe administrative për mirëmbajtjen dhe funksionimin e Komisionit.

3. Sekretariati duhet të ketë ose të sigurojë ekspertizën e nevojshme për kryerjen e funksioneve të tij, përfshirë ekspertizën e mjaftueshme në ligjin përkatës vendas dhe njohuri në gjuhët përkatëse.

4. Rregullat dhe dispozitat e personelit të Këshillit të Europës do të zbatohen për Sekretariatin. Shtetas të të gjitha shteteve anëtare të Këshillit të Europës dhe shtetas të të gjitha Anëtarëve do të jenë të kualifikuar për emërim si Anëtarë të stafit të Komisionit. Asambleja mund të bëjë përjashtime nga rregullat dhe dispozitat e zbatueshme të Këshillit të Europës, përfshirë lidhjen me shtetësinë e stafit, nëse kjo ndihmon në kryerjen e funksioneve të Komisionit. Këto përjashtime të miratuara do t'i komunikohen Komitetit të Ministrave dhe Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

Neni 14

Drejtori Ekzekutiv

1. Drejtori Ekzekutiv përfaqëson Komisionin dhe ka të drejtë të veprojë në emër të tij.

2. Drejtori Ekzekutiv ka të drejtë të lidhë kontrata, marrëveshje dhe dakordësime në emër të Komisionit. Çdo marrëveshje ndërkombëtare do të lidhët nga Drejtori Ekzekutiv në emër të Komisionit, pas miratimit paraprak nga Asambleja. Çdo rregullim me organe kombëtare ose ndërkombëtare që parashikon shkëmbim informacioni mbi kërkesat ose provat do të lidhët nga Drejtori Ekzekutiv në emër të Komisionit, pas miratimit paraprak nga Këshilli.

3. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do t'i delegojë Drejtorit Ekzekutiv fuqitë e nevojshme për ushtrimin e detyrave të tij lidhur me Sekretariatin.

4. Drejtori Ekzekutiv do të:

(a) ketë përgjegjësi ditore për mbikëqyrjen dhe administrimin e punës së Sekretariatit;

(b) sigurojë mbështetje përmbajtësore, teknike, administrative dhe organizative për punën e Asamblesë, Këshillit dhe Paneleve, duke përfshirë lidhjen e rregullt dhe përgatitjen e mbledhjeve të tyre;

(c) jetë përgjegjës për dërgimin e kërkesave Paneleve për shqyrtim dhe për t'ua përcjellë rekomandimet Paneleve te Këshilli;

(d) bashkëpunojë me organet kombëtare dhe ndërkombëtare për çështje të ndryshme që lidhen me punën e Komisionit, përfshirë çështjet që lidhen me kërkesat dhe provat; dhe

(e) kryejë çdo funksion tjetër që i është ngarkuar Drejtorit Ekzekutiv nga kjo Konventë ose që i është deleguar nga Asambleja dhe/ose Këshilli.

5. Drejtori Ekzekutiv zgjidhet nga Asambleja. Pas zgjedhjes nga Asambleja, Drejtori Ekzekutiv emërohet nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës dhe pritet të shërbejë për një mandat të rinovueshëm prej 4 vjetësh.

6. Anëtarët ftohen të nominojnë kandidatë për këtë pozicion, duke marrë parasysh natyrën e Kërkesave para Komisionit.

7. Kandidatët duhet të jenë individë me integritet, karakter të lartë moral, përvojë të përshtatshme dhe kualifikime profesionale për këtë rol.

Neni 15
Pavarësia

1. Komisionerët, si dhe Drejtori Ekzekutiv dhe Anëtarët e tjerë të Sekretariatit, do të jenë të pavarur në ushtrimin e detyrave të tyre.

2. Në ushtrimin e detyrave të tyre, komisionerët, si dhe Drejtori Ekzekutiv dhe Anëtarët e tjerë të Sekretariatit, nuk do të kërkojnë ose pranojnë udhëzime nga ndonjë qeveri apo nga ndonjë autoritet apo subjekt tjetër jashtë Komisionit. Ata do të përmbahen nga çdo veprim që mund të ndikojë negativisht në pozicionin e tyre si zyrtarë ndërkombëtarë përgjegjës vetëm ndaj Komisionit.

3. Secili Anëtar, si dhe Këshilli i Europës dhe organet e tij, angazhohen të respektojnë karakterin ekskluzivisht të pavarur të përgjegjësive të Komisionerëve, si dhe të Drejtorit Ekzekutiv dhe Anëtarëve të tjerë të Sekretariatit, dhe të mos përpiqen të ndikojnë tek ata në kryerjen e detyrave të tyre.

4. Komisionerët, si dhe Drejtori Ekzekutiv dhe Anëtarët e tjerë të Sekretariatit, nuk duhet të kenë asnjë interes personal ose financiar në asnjë çështje para Komisionit. Çdo konflikt interesi duhet të deklarohet dhe të trajtohet në përputhje me rregullat e Komisionit.

5. Rregullat për konfliktet e interesit dhe deklarimin e tyre për Komisionerët, si dhe, sipas rastit, për Drejtorin Ekzekutiv dhe Anëtarët e tjerë të Sekretariatit, do të miratohen nga Këshilli.

KAPITULLI V
KËRKESAT DHE PROCEDURA

Neni 16
Shqyrtimi i Kërkesave nga Panelet

1. Panelet do të shqyrtojnë kërkesat, do të përcaktojnë nëse ato janë të bazuara, do të përcaktojnë shumën e kompensimit që duhet për çdo kërkesë, dhe do të bëjnë rekomandime për vendime për miratim nga Këshilli në përputhje me Rregullat dhe Rregulloret përkatëse.

2. Panelet mund t'i kërkojnë Sekretariatit të angazhojë ekspertë për t'i ndihmuar kur kërkohet njohuri, ekspertizë apo përvojë e specializuar.

3. Shqyrtimi i Kërkesave do të kryhet në bazë të Rregullave dhe Rregulloreve. Panelet do të përcaktojnë mënyrat e tyre të punës.

4. Sekretariati do tu sigurojë ndihmën administrative, teknike, ligjore etj. Panelve në ushtrimin e funksioneve të tyre, por nuk do të jetë i përfshirë në vendimmarrjen përfundimtare të Paneleve.

Neni 17

Marrja e Vendimeve nga Panelet

1. Panelet do të përpiqen t'i miratojnë rekomandimet e tyre me konsensus. Kur përpjekjet për të arritur konsensus të kenë shterur, rekomandimet për vendime do të miratohen me shumicë votash nga Komisionerët në Panel. Sekretariati do të mbajë shënim nëse vendimet e Paneleve janë marrë me konsensus apo me shumicë dhe rezultatin e çdo votimi.

2. Rekomandimet për vendimet e Paneleve duhet të jenë të arsyetuara.

Neni 18

Marrja e Vendimeve me Rekomandimet e Paneleve

1. Këshilli do të shqyrtojë rekomandimet e Paneleve lidhur me kërkesat sa më shpejt që të pranohen rekomandimet. Në vlerësimin e rekomandimeve, Këshilli do të ndjekë grumbullimin e kërkesave, nëse ka, të shfrytëzuar nga Panelet.

2. Pas shqyrtimit të plotë nga Këshilli, një rekomandim duhet të konsiderohet i miratuar nga Këshilli, përveç rastit kur Këshilli vendos, me arsyet e përcaktuara në Rregulla dhe Rregullore, ta kthejë rekomandimin te Paneli, duke dhënë arsyet e vendimit së bashku me udhëzimet e mëtejshme, të cilat do të jenë pjesë integrale e vendimit të Këshillit.

3. Paneli do të marrë parasysh udhëzimet e Këshillit dhe do të bëjë një rekomandim të ri, sipas rastit.

4. Në situatat e jashtëzakonshme të parashikuara në Rregulla dhe Rregullore, Këshilli mund t'ia referojë rekomandimin e një Paneli, një paneli tjetër rishqyrtimi, të ngritur *ad hoc* nga Këshilli për këtë qëllim.

5. Paneli *ad hoc* i rishikimit do të përbëhet nga tre Kryetarë Panelesh. Nenet 16 dhe 17 të kësaj Konvente do të aplikohen për panelet e veçanta të rishikimve dhe punën e tyre.

6. Pas shqyrtimit të plotë nga Këshilli, rekomandimi i panelit të veçantë të rishikimit do të konsiderohet i miratuar nga Këshilli, përveç rasteve kur Këshilli ja referon çështjen Asamblesë, e cila do të vendosë përfundimisht në vend të Këshillit.

7. Një rekomandim i miratuar në përputhje me këtë nen do të jetë vendimi përfundimtar i Komisionit lidhur me çdo kërkesë në fjalë dhe nuk do të jetë subjekt i ankimeve apo rishikimeve të mëtejshme.

8. Një regjistër i vendimmarrjeve të Asamblesë, Këshillit dhe çdo paneli të veçantë të rishikimit do të mbahet nga Sekretariati.

Neni 19

Aktgjykimet ose Vendimet nga Gjykatat, Tribunalet dhe Organet e Tjera Gjyqësore

1. Në vendimmarrjen e tyre, Panelet dhe Këshilli do të marrin parasysh, sipas rastit, aktgjykimet ose vendimet përkatëse të gjykatave ose tribunaleve dhe organeve të tjera gjyqësore të krijuara sipas së drejtës ndërkombëtare.

2. Panelet dhe Këshilli mund të marrin parasysh gjithashtu aktgjykimet ose vendimet përkatëse të çdo gjykate dhe tribunali kombëtar.

3. Komisioni, nëpërmjet organeve të tij, duhet të marrë masat e duhura për të siguruar që asnjë kërkues të mos marrë kompensim të dyfishtë për të njëjtën dëm, humbje apo lëndim. Anëtarët do të përpiqen që ta mbështesin Komisionin në këtë drejtim, sidomos nëpërmjet shkëmbimit të informacionit me Komisionin, sipas rastit.

Neni 20
Standardet dhe Garancitë

1. Komisioni, duke përfshirë Këshillin, Panelet dhe Sekretariatin e tij, do të veprojë sipas standardeve më të larta të pavarësisë, paanshmërisë, drejtësisë dhe objektivitetit.
2. Komisioni do të veprojë në mënyrë transparente, duke informuar rregullisht publikun për aktivitetet e tij, dhe duke i mbrojtur siç duhet të dhënat personale. Rregullat mbi transparencën, përfshirë ata të publikimit të vendimeve të Komisionit, do të miratohen nga Këshilli.
3. Këshilli do të miratojë rregulla për mbrojtjen e të dhënave personale dhe konfidencialitetin.
4. Të gjitha procedurat e Komisionit do të zhvillohen duke siguruar mbrojtjen e duhur proceduriale.

Neni 21
Financimi i Kompensimit të Caktuar dhe Zbatimi

1. Anëtarët e dinë se Federata Ruse duhet të mbajë pasojat ligjore të të gjitha veprimeve të saj ndërkombëtarisht të paligjshme, duke përfshirë edhe përgjegjësinë për kompensimin e dëmit, përfshirë çdo dëm të shkaktuar nga këto veprime. Prandaj pritet që Federata Ruse të financojë kompensimin e vendosur dhe të caktuar nga Komisioni sipas kësaj Konvente.
2. Anëtarët, me përjashtim të Federatës Ruse, nuk do të jenë të detyruar të financojnë kompensimin e vendosur dhe caktuar nga Komisioni.
3. Vendimet e Komisionit nuk mund të zbatohen nëpërmjet gjykatave apo institucioneve të tjera gjyqësore ose të ashtëquajtura gjyqësore brenda juridiksioneve kombëtare të Anëtarëve, përveç rastit kur një Anëtari i lejohet shprehimisht kjo sipas legjislacionit kombëtar të atij anëtari.

Neni 22
Mekanizmat për Pagesën e Kompensimit të Caktuar

Asambleja mund të shqyrtojë mekanizmat për pagesën e kompensimit të caktuar pasi të jenë bërë të disponueshme fondet, përfshirë pagesën nga ndonjë fond kompensimi që mund të krijohet ose caktohet për këtë qëllim në një moment që Asambleja e gjykon të përshtatshëm.

KAPITULLI VI
FINANCIMI I KOMISIONIT

Neni 23
Financimi dhe Buxheti

